



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada – Government

Ministria e Sportit dhe Rinisë – Ministarstvo Sporta i Omladine – Ministry of Sport and Youth

Raporti Narrativ i Punës së Federatës

RAPORTI 3 MUJOR NARRATIV (maksimumi 15 faqe)

Versioni përfundimtar i raportit i aprovuar nga MRS duhet të nënshkruhet nga Kryetari/ja (që përfaqëson Federatën në kontratën e Memorandumit) dhe të dorëzohet i shtypur tek MRS. Informacioni i dhënë më poshtë duhet të jetë në përputhje me informacionin financiar të dhënë në raportin financiar.

Ju lutemi shkruani raportin në kompjuter. Raportet e shkruara me dorë nuk pranohen.

Ju lutemi zgjeroni paragrafët e raportit sipas nevojës dhe shtoni informacione të tjera që mund t'i konsideroni të rëndësishme.

MRS do të refuzojë çdo raport jo të plotë ose të hartuar dobët.

*Pas hartimit të raportit, udhëzimet e mësipërme mund të fshihen.

1. Informacioni për Federatën/ Memorandumi

1.1 Numri i kontratës/Memorandumit:	
1.2 Emri i Federatës :	Federata e Para Boccia të Kosovës
1.3 Emri, mbiemri dhe pozita e personit kontaktues përgjegjës për këtë raport:	Erëmal Gashi, Sekretar i Përgjithshëm
1.4 Emri, mbiemri dhe pozita e nënshkruesit të Memorandumit :	Murat Murati, Kryetar
1.5 Data e fillimit dhe e mbarimit të Memorandumit (dd/mm/vv - dd/mm/vv):	01.01.2026 - 31.12.2026
1.6 Periudha e raportimit (dd/mm/vv - dd/mm/vv), dhe specifiko TM1, TM2, TM3 apo TM4	01.01.2026 - 30.06.2026 TM1, TM2
1.7 Synimet e Federatës përgjatë këtij Memoradumi (sipas F1- Planit vjetor të Punës)	Të arrijmë sa më shumë rezultate për të gjitha grupmoshat dhe në të gjitha kategoritë ku zhvillohen garat në sportin e boccias në Kosovës si dhe rritje e pjesëmarrje në turnet kombëtarë të boccias.
1.8 Shuma e kështit që kërkohet (sipas Memorandumit dhe ndarjes në TM):	Dy këste nga 15,000.00€
1.9 Shuma totale e Memorandumit:	30,000.00€
1.10 Buxheti total i shpenzuar deri më tani:	15,000.00€

1.11 Shuma e mbetur në bankën tuaj nga Kësti i Memorandumit:	0.00€
2. Vlerësimi i aktiviteteve të zbatuara të Memorandumit	
2.1 Përmbledhja e përgjithshme e aktiviteteve, progresi, dhe ndikimi (Ju lutemi jepni përmbledhjen e përgjithshme të projektit/programit, progresit në arritjen e synimeve dhe aktivitetet e zbatuara gjatë këtij 3 muaji, sipas planifikimit në F1- Plani Vjetor i Punës së Federatës)	
- Promovim gjatë takimeve me klubet sportive dhe anëtarësinë e tyre, ku janë ofruar informata se si funksionojnë klubet dhe organizata sportive sipas legjislacionit në fuqi ku edhe jemi përgaditur me dokumentacion të nevojshëm për licencim në Ministrinë e Sportit dhe Rinisë të klubeve të boccias dhe të Federatës së Para Boccia të Kosovës. - Organizim i trajnimeve me klubet sportive të boccias, ku janë përdorur module të trajnimeve për klubet për funksionim të klubeve sipas politikave të reja dhe kemi arritur që të ngrisim kapacitetet e klubeve sportive të boccias. - Takime me klubet e boccias për zbatim të politikave dhe mbledhjen e të dhënave të tyre, ku janë zhvilluar takime konsultative me klubet dhe anëtarët e tyre për të parë zbatimin e politikave të klubeve dhe mbledhjen e informatave nga terreni, direkt nga klubet sportive për gjendjen faktike të zhvillimit të klubeve të boccias në Kosovë. - Krijimi, zhvillim dhe mirëmbajtja web-faqes të FPBOK: www.fpbok-kosova.com për prezantim në promovim të aktiviteteve, ku është bërë promovim i strukturës organizative, promovim i anëtarësisë e dhe promovim i aktivitetit me qëllim të masovizimit të sportit të boccias në Kosovë dhe rritjes së përfituesve si dhe vendosja e dokumenteve dhe raporteve të FPBOK, me të cilat rritet transparenca dhe llogaridhënja para publikut. - Organizimi i garave sportive ekipore në Boccia, ku është mbajtur turneu i parë i kampionatit, ku është promovuar dhe zhvilluar sporti i boccias tek parasporistët, personat me aftësi të kufizuara të të gjitha grupmoshave. Vlen të theksohet se është rritur dukshëm në krahasim me vitet paraprake konkurrenca në kampionatin ekipor boccia 2026. Fillimisht klasifikatorët e kanë kryer klasifikimin e lojtarëve e më pas është zhvilluar turneu i parë sipas planifikimit i kampionatit ekipor në Boccia 2026. - Organizimi i garave sportive individuale në Boccia, BC1, BC2, BC3 dhe BC4, ku është zhvilluar turneu i parë. Në këtë aktivitet është promovuar dhe zhvilluar sporti i boccias tek parasporistët, personat me aftësi të kufizuara të të gjitha grupmoshave. Vlen të përmendet që përpos konkurrencës është rritur numri i garuesve dhe klasifikatorët kanë bërë ndarjen adekuate të sportistëve që të garojnë sipas grupeve adekuate të boccias. Me suksese të larta është zhvilluar turneu i parë i kampionatit individual BC1, BC2, BC3 dhe BC4 në Boccia 2026. - Organizimi i garave sportive individuale në Boccia, Turneu i parë i Kampionatit në kategorinë e femrave, ku është bërë promovimi dhe zhvillimi i sportit të boccias tek parasporistët, personat me aftësi të kufizuara të të gjitha grupmoshave të gjinisë femrore. Është nxitur konkurrenca në kampionatin individual në boccia 2026 në kategorinë e femrave. Vlen të theksohet që pas klasifikimit të parasportistëve të boccias është vërejtur rritja e numrit të garuesve dhe ndarja e sportistëve që të garojnë sipas grupeve adekuate të boccias. - Organizim i trajnimeve me klubet sportive të boccias për zhvillim të sportit të vajzave dhe rendësisë së udhëheqjes nga femrat në pozita vendimmarrëse, ku përmes moduleve të trajnimeve për zhvillim të sportit të vajzave dhe rendësisë së udhëheqjes nga femrat në pozita vendimmarrëse. Është arritur me suksese ngritja e kapaciteteve të klubeve sportive të boccias për zhvillim të sportit të vajzave dhe rendësisë së udhëheqjes nga femrat në pozita vendimmarrëse. - Aktivitet për shënimin e përvjetorit të themelimit të Federatës së Para Boccia të Kosovës, ku është bërë organizim i ekspozitës me fotografi të aktiviteteve të boccias në Kosovë nga	

themelimi e deri tani ku me rastin e shënimit të dites se themelimit të FPBOK është rritur që të bëhet promovimi i masovizimit të sportit të boccias në Kosovë

10. Trajnime për trajner të nivelit vendor, ku është bërë organizim i trajnimeve me module profesionale sportive për trajner të sportit të boccias në nivelin kombëtar. Vlen të përmendet që 2 trajner kombëtarë, të trajnuar dhe licencuar nga Federata Kroate e Boccias, kanë bërë organizimin e trajnimeve teorike dhe praktike për licensimin e trajnereve të rinjë vendor nga Federata e Para Boccia të Kosovës.
11. Trajnime për gjygtar të nivelit vendor, ku është bërë organizim i trajnimeve me module profesionale sportive për gjygtar të sportit të boccias në nivelin kombëtar. Vlen të përmendet që 2 gjygtarë kombëtarë, të trajnuar dhe licencuar nga Federata Kroate e Boccias, kanë bërë organizimin e trajnimeve teorike dhe praktike për licensimin e gjygtarëve të rinjë vendor nga Federata e Para Boccia të Kosovës.

2.2 Arritjet kryesore (Identifikoni dhe shpjegoni shkurtimisht arritje për të gjitha aktivitetet e planifikuara sipas F1- Plani Vjetor i Punës, gjatë zbatimit të aktiviteteve të Memorandumit në këtë 3 muajor. Shpjegoni ndryshimin konkret të paraqitur për grupin e synuar të përfituesve ose individëve brenda këtyre grupeve.)

Gjatë periudhës janar - qershor 2026 janë realizuar me sukses të gjitha aktivitetet e planifikuara sipas Planit Vjetor të Punës (F1), në përputhje të plotë me Memorandumin e bashkëpunimit dhe pa ndryshime thelbësore nga planifikimi i aprovuar. Zbatimi i aktiviteteve ka kontribuar në forcimin e kapaciteteve organizative, administrative dhe profesionale të Federatës së Para Boccia të Kosovës (FPBOK) dhe klubeve anëtare, si dhe në zhvillimin, promovimin dhe masovizimin e sportit të boccias për personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës.

Në kuadër të aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve organizative janë zhvilluar takime promovuese dhe konsultative me klubet sportive dhe anëtarësinë e tyre, gjatë të cilave janë ofruar informata lidhur me funksionimin e organizatave sportive sipas legjislacionit në fuqi. Është përgatitur dokumentacioni i nevojshëm për procesin e licencimit të klubeve sportive të boccias dhe të Federatës në Ministrinë e Sportit dhe Rinisë. Përmes trajnimeve të organizuara me klubet sportive janë trajtuar temat që lidhen me qeverisjen e mirë, menaxhimin organizativ, funksionimin e klubeve sipas politikave të reja dhe zbatimin e standardeve ligjore, duke ndikuar në ngritjen e kapaciteteve të tyre institucionale.

Gjithashtu, janë organizuar trajnime të veçanta me klubet sportive për zhvillimin e sportit të vajzave dhe fuqizimin e rolit të grave në pozita vendimmarrëse. Përmes moduleve të specializuara të trajnimit është rritur vetëdijesimi për rëndësinë e barazisë gjinore në sport, është inkurajuar pjesëmarrja më e madhe e vajzave dhe grave në boccia dhe janë fuqizuar kapacitetet e klubeve për të promovuar përfshirjen dhe udhëheqjen e grave në strukturat drejtuese.

Përmes takimeve të rregullta me klubet sportive është monitoruar zbatimi i politikave dhe janë mbledhur të dhëna nga terreni për gjendjen faktike të zhvillimit të sportit të boccias në Kosovë. Këto aktivitete kanë mundur identifikimin e nevojave të klubeve dhe përmirësimin e koordinimit ndërmjet Federatës dhe anëtarëve të saj.

Një arritje e rëndësishme gjatë kësaj periudhe është zhvillimi dhe mirëmbajtja e ueb-faqes zyrtare të Federatës, përmes së cilës është rritur transparenca institucionale, promovimi i aktiviteteve, publikimi i dokumenteve dhe raporteve zyrtare, si dhe informimi i vazhdueshëm i sportistëve, klubeve dhe publikut. Kjo ka ndikuar në rritjen e dukshmërisë së sportit të boccias dhe promovimin e mundësive për përfshirje

të personave me aftësi të kufizuara.

Në aspektin sportiv janë organizuar me sukses turneu i parë i Kampionatit Ekipor në Boccia, turneu i parë i Kampionatit Individual në kategoritë BC1, BC2, BC3 dhe BC4, si dhe turneu i parë i Kampionatit Individual në kategorinë e femrave. Para zhvillimit të garave është realizuar klasifikimi funksional i sportistëve nga klasifikatorët përkatës, duke siguruar zhvillimin e garave sipas standardeve të sportit. Gjatë kësaj periudhe është shënuar rritje e numrit të garuesve, rritje e konkurrencës sportive dhe pjesëmarrje më e madhe e parasportistëve, përfshirë edhe sportistet femra.

Po ashtu, janë organizuar trajnime profesionale për trajnerë dhe gjyqtarë të nivelit vendor, të udhëhequra nga trajnerë dhe gjyqtarë kombëtarë të licencuar, me qëllim të krijimit të kuadrove të reja profesionale për zhvillimin e sportit të boccias në Kosovë. Përmes këtyre trajnimeve janë ngritur njohuritë teorike dhe praktike të pjesëmarrësve, duke përmirësuar cilësinë e procesit stërvitor, organizimin e garave dhe zbatimin e rregullave të sportit.

Në kuadër të promovimit të sportit është organizuar edhe aktiviteti për shënimin e përvjetorit të themelimit të Federatës së Para Boccia të Kosovës, ku përmes ekspozitës me fotografi dhe prezantimit të zhvillimit të sportit ndër vite është promovuar puna e Federatës, janë prezantuar arritjet kryesore dhe është rritur ndërgjegjësimi për rëndësinë e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në sport.

Si rezultat i realizimit të gjitha aktiviteteve të planifikuara, është arritur përmirësim i dukshëm i funksionimit të klubeve sportive, ngritje e kapaciteteve organizative dhe profesionale të Federatës dhe klubeve, rritje e transparencës institucionale, rritje e pjesëmarrjes dhe konkurrencës në gara, zhvillim i kuadrove profesionale përmes licencimit të trajnerëve dhe gjyqtarëve, si dhe fuqizim i rolit të grave dhe vajzave në sport. Përfituesit kryesorë të aktiviteteve kanë qenë personat me aftësi të kufizuara, parasportistët e sportit të boccias të cilëve u janë krijuar mundësi më të mëdha për pjesëmarrje aktive në sport, zhvillim të aftësive sportive, integrim social, përfaqësim të barabartë dhe përmirësim të cilësisë së aktiviteteve sportive në nivel kombëtar.

2.3 A keni hasur ndonjë sfidë dhe vështirësi gjatë zbatimit të Memorandumit? (Shtjelloni sfidat e hasura dhe si iu jeni përgjigjur. Si ka ndikuar në zbatimin e aktiviteteve tuaja? A vazhdojnë sfidat? Nëse po, cili është veprimi i propozuar nga ju?)

Gjatë zbatimit të Memorandumit janë hasur disa sfida organizative, kryesisht në koordinimin e pjesëmarrjes së klubeve dhe parasportistëve nga komuna të ndryshme, organizimin e klasifikimit të sportistëve para garave, si dhe në përgatitjen e dokumentacionit për licencim. Gjithashtu, sfidë ka qenë rritja e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave në sport dhe në pozita vendimmarrëse. Këto sfida janë adresuar përmes planifikimit të mirë, koordinimit të vazhdueshëm me klubet, ofrimit të mbështetjes teknike dhe organizimit të trajnimeve shtesë. Sfidat nuk kanë ndikuar në realizimin e aktiviteteve, të cilat janë zbatuar sipas planifikimit. Në vazhdim propozohet forcimi i bashkëpunimit me klubet dhe institucionet për të rritur pjesëmarrjen dhe për të përmirësuar mbështetjen logjistike për personat me aftësi të kufizuara.

2.4 Rezultatet e arritura (Përshkruani rezultatet e arritura **për të gjitha aktivitetet** sipas planifikimit në F1- Plani Vjetor i Punës, duke treguar ndryshimin e arritua gjatë këtij 3 muaji. Shtjelloni rezultatet për grupin e synuar për secilin aktivitet të planifikuar për këtë periudhë).

Aktiviteti 1: Titulli: rendit aktivitetet

Nën- aktivitetet e zbatuara <ju lutem jepni më shumë detaje>:

Rezultatet e synuara-
Rezultatet e arritura –
Sqarime shtesë:

Aktiviteti: Promovimi dhe përgatitja për licencimin e klubeve sportive dhe FPBOK

Nën-aktivitetet e zbatuara:

- Organizimi i takimeve me klubet sportive dhe anëtarët.
- Informimi mbi legjislacionin sportiv dhe procedurat e licencimit.
- Përgatitja e dokumentacionit për licencimin e klubeve dhe Federatës.

Rezultatet e synuara:

Funksionimi i klubeve sipas legjislacionit dhe përgatitja për licencim.

Rezultatet e arritura:

Klubet janë informuar dhe është përgatitur dokumentacioni i nevojshëm për licencim.

Sqarime shtesë:

Aktiviteti është realizuar sipas planifikimit.

Aktiviteti: Trajnime për klubet sportive të boccias

Nën-aktivitetet e zbatuara:

- Zhvillimi i trajnimeve.
- Prezantimi i moduleve për menaxhim dhe funksionim të klubeve.

Rezultatet e synuara:

Ngritja e kapaciteteve të klubeve sportive.

Rezultatet e arritura:

Përfaqësuesit e klubeve kanë përmirësuar njohuritë për menaxhimin dhe funksionimin e klubeve.

Sqarime shtesë:

Trajnimet janë realizuar sipas planit.

Aktiviteti: Takime me klubet për zbatimin e politikave dhe mbledhjen e të dhënave

Nën-aktivitetet e zbatuara:

- Takime konsultative.
- Monitorimi i zbatimit të politikave.
- Mbledhja e të dhënave nga klubet.

Rezultatet e synuara:

Përmirësimi i koordinimit dhe identifikimi i nevojave të klubeve.

Rezultatet e arritura:

Janë mbledhur të dhëna dhe janë identifikuar nevojat për zhvillimin e sportit.

Sqarime shtesë:

Aktiviteti është realizuar sipas planifikimit.

Aktiviteti: Zhvillimi dhe mirëmbajtja e ueb-faqes së FPBOK

Nën-aktivitetet e zbatuara:

- Përditësimi i ueb-faqes.
- Publikimi i aktiviteteve, dokumenteve dhe raporteve.

Rezultatet e synuara:

Rritja e transparencës dhe promovimit të Federatës së Para Boccia të Kosovës.

Rezultatet e arritura:

Ueb-faqja është përditësuar rregullisht dhe është rritur informimi i publikut.

Sqarime shtesë:

Është siguruar transparencë institucionale.

Aktiviteti: Organizimi i Kampionatit Ekipor në Boccia 2026

Nën-aktivitetet e zbatuara:

- Klasifikimi i parasportistëve.
- Organizimi i turneut të parë.

Rezultatet e synuara:

Rritja e pjesëmarrjes dhe konkurrencës.

Rezultatet e arritura:

Turneu është zhvilluar me sukses dhe është rritur konkurrenca ndërmjet ekipeve.

Sqarime shtesë:

Aktiviteti është realizuar sipas planit.

Aktiviteti: Organizimi i Kampionatit Individual Boccia 2026 BC1, BC2, BC3 dhe BC4

Nën-aktivitetet e zbatuara:

- Klasifikimi i parasportistëve.
- Organizimi i turneut individual.

Rezultatet e synuara:

Zhvillimi i garave individuale sipas kategorive.

Rezultatet e arritura:

Është rritur numri i garuesve dhe garat janë zhvilluar sipas standardeve.

Sqarime shtesë:

Aktiviteti është realizuar me sukses.

Aktiviteti: Kampionati Individual në kategorinë e femrave Boccia 2026

Nën-aktivitetet e zbatuara:

- Organizimi i turneut për parasportistet.
- Klasifikimi i pjesëmarrëseve.

Rezultatet e synuara:

Rritja e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave në sportin e boccias.

Rezultatet e arritura:

Është zhvilluar turneu dhe është nxitur pjesëmarrja e sportisteve në garat e femrave në boccia.

Sqarime shtesë:

Aktiviteti ka kontribuar në promovimin e pjesëmarrjes së femrave në aktivitete sportive.

Aktiviteti: Trajnime për zhvillimin e sportit të vajzave dhe udhëheqjen e grave

Nën-aktivitetet e zbatuara:

- Organizimi i trajnimeve me klubet.
- Prezantimi i moduleve për barazi gjinore dhe udhëheqje.

Rezultatet e synuara:

Rritja e kapaciteteve të klubeve për zhvillimin e sportit të vajzave.

Rezultatet e arritura:

Klubet kanë përmirësuar njohuritë për përfshirjen e vajzave dhe grave në sport dhe në pozita vendimmarrëse.

Sqarime shtesë:

Aktiviteti është realizuar sipas planifikimit.

Aktiviteti: Shënimi i përvjetorit të themelimit të FPBOK**Nën-aktivitetet e zbatuara:**

- Organizimi i ekspozitës me fotografi.
- Promovimi i historikut dhe aktiviteteve të Federatës së Para Boccia të Kosovës.

Rezultatet e synuara:

Promovimi i sportit të boccias.

Rezultatet e arritura:

Është rritur dukshmëria e Federatës së Para Boccia të Kosovës dhe ndërgjegjësimi për sportin.

Sqarime shtesë:

Aktiviteti është realizuar me sukses, me pjesëmarrje të anëtarëve, insitucioneve, përkrahësëve, mbështetësëve dhe donatorëve.

Aktiviteti: Trajnime për trajnerë të nivelit vendor**Nën-aktivitetet e zbatuara:**

- Zhvillimi i trajnimeve teorike dhe praktike për trajner të boccias në nivel kombëtar.
- Angazhimi i trajnerëve të licencuar.

Rezultatet e synuara:

Ngritja e kapaciteteve profesionale të trajnerëve.

Rezultatet e arritura:

Janë përgatitur trajnerë vendorë me njohuri profesionale për sportin e boccias.

Sqarime shtesë:

Trajnimet janë zhvilluar sipas planit.

Aktiviteti: Trajnime për gjyqtarë të nivelit vendor

Nën-aktivitetet e zbatuara:

- Zhvillimi i trajnimeve teorike dhe praktike për gjyqtarë të boccias në nivel kombëtarë.
- Angazhimi i gjyqtarëve të licencuar.

Rezultatet e synuara:

Ngritja e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve për nivel kombëtarë të garave.

Rezultatet e arritura:

Janë përgatitur gjyqtarë vendorë për zbatimin korrekt të rregullave të sportit.

Sqarime shtesë:

Aktiviteti është realizuar sipas planifikimit dhe ka kontribuar në rritjen e cilësisë së organizimit të garave në të gjitha Kampionatet, përkatësisht turnet e parë të organizuara në vitin 2026.

2.5 Përshkrimi i aktiviteteve (Përshkruani aktivitetet e planifikuara në këtë 3 mujor bazuar në F1- planin e vjetor të punës. Për secilin aktivitet jepni një shpjegim se si e keni zbatuar, pjesëmarrjen e grupeve të synuara dhe ndërlidhjen me arritjet kryesore)

Aktiviteti 1: Titulli: rendit aktivitetet me detaje

Nën- aktivitetet e zbatuara <ju lutem jepni më shumë detaje>:

Rezultatet e këtij aktiviteti <paraqisni informacione mbi përfituesit e drejtpërdrejtë dhe përfituesit përfundimtarë për secilën aktivitet. Kur janë në dispozicion, të dhënat duhet të paraqiten të ndara sipas gjinisë, grupmoshës së sportistëve dhe grupit të nënpërfaqësuar (specifikoni grupin, siç janë minoritetet, të rinjtë, të moshuarit, LGBTI, personat me aftësi të kufizuara ose të moshuar) Përfituesit e Memorandumit që përfitojnë nga më shumë se një aktivitet duhet të numërohen një herë. Kur është e mundur, rezultatet e tjera të shprehen gjithashtu në shifra>:

Gjatë periudhës janar - qershor 2026 janë realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara sipas Planit Vjetor të Punës (F1), pa devijime nga planifikimi. Aktivitetet kanë përfshirë promovimin dhe përgatitjen e klubeve për licencim, organizimin e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të klubeve, monitorimin e zbatimit të politikave, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e ueb-faqes së Federatës së Para Boccia të Kosovës, organizimin e kampionateve ekipore dhe individuale, përfshirë kategorinë e femrave, trajnimet për zhvillimin e sportit të vajzave dhe fuqizimin e grave në pozita vendimmarrëse, shënimin e përvjetorit të themelimit të Federatës, si dhe trajnimet profesionale për trajnerë dhe gjyqtarë vendorë.

Në të gjitha aktivitetet kanë marrë pjesë personat me aftësi të kufizuara, parasportistët e sportit të boccias të të gjitha grupmoshave, së bashku me klubet sportive, trajnerët, gjyqtarët dhe përfaqësuesit e Federatës së Para Boccia të Kosovës. Aktivitetet janë zbatuar përmes takimeve, trajnimeve, garave sportive, aktiviteteve promovuese dhe mbështetjes teknike për klubet.

Si rezultat, janë ngritur kapacitetet organizative dhe profesionale të klubeve dhe Federatës së Para Boccia të Kosovës, është përmirësuar funksionimi i tyre sipas legjislacionit në fuqi, është rritur transparenca institucionale dhe është shtuar pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në aktivitetet sportive. Gjithashtu, është rritur konkurrenca në kampionate, janë krijuar kuadro të reja të trajnerëve dhe gjyqtarëve vendorë, është promovuar barazia gjinore dhe është forcuar përfshirja e

vajzave dhe grave në sport. Këto aktivitete kanë kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin dhe masovizimin e sportit të boccias në Kosovë dhe në krijimin e mundësive më të mira për pjesëmarrje aktive të personave me aftësi të kufizuara, përkatësisht parasportistëve të boccias.

2.6 Aktivitetet që nuk janë zbatuar. Nëse ndonjë aktivitet nuk është zbatuar në përputhje me F1- Planin Vjetor të Punës dhe Buxhetin e Planifikuar specifikoni arsyen pse nuk janë zbatuar dhe masat e marra nga ju. Ju lutemi jepni detaje, përfshirë vonesën ose anulimin e aktiviteteve, dhe mënyrën se si janë adresuar. Ju lutemi shënoni çdo aktivitet të parashikuar në planin e aktiviteteve për periudhën raportuese që nuk është zbatuar dhe shpjegoni arsyet për këtë.)

Aktiviteti 1: Titulli:

Nën- aktiviteti i cili nuk është zbatuar <ju lutem jepni më shumë detaje, pse nuk është zbatuar, masat që keni ndërmarrë ju për të adresuar këtë aktivitet apo nëse planifikohet të zbatohet në ndonjë 3 muor tjetër>:

Janë zbatuar të gjitha aktivitetet e planifikuara në përputhje me F1- Planin Vjetor të Punës dhe Buxhetin e Planifikuar.

2.7 Aktivitete të paplanifikuara (Shpjegoni çdo aktivitet tjetër që është zbatuar dhe që nuk ka qenë i parashikuar në F1- Planin Vjetor të Punës së Federatës. Nëse nuk ka aktivitete të tilla, kjo hapësirë mbetet e zbrazët)

/

2.8 Vlerësimi nga pjesëmarrësit (Cilat ishin vlerësimet dhe komentet nga pjesëmarrësit në aktivitete? Ju lutemi bëni përmbledhjen e rezultateve dhe komenteve të marra, përfshirë ato të përfituesve. Nëse keni përdorë pyetësorë për matje të performancës apo knaqshmërisë së pjesëmarrësve, ndani përmbledhjen e këtyre pyetësorëve dhe raportet e tyre me MRS. Përtej vlerësimeve dhe komenteve të përgjithshme, kur është e mundur, paraqitni një qasje kritike dhe analitike bazuar në vlerësimet dhe komentet e marra.)

Gjatë zbatimit të aktiviteteve nuk janë përdorur pyetësorë formalë për matjen e kënaqshmërisë apo performancës së pjesëmarrësve. Megjithatë, vlerësimi është realizuar përmes diskutimeve të hapura dhe komunikimit të drejtpërdrejtë me parasportistët, trajnerët, gjyqtarët, përfaqësuesit e klubeve sportive dhe shoqëruesit e parasportistëve gjatë aktiviteteve të zhvilluara.

Në përgjithësi, pjesëmarrësit kanë shprehur vlerësime pozitive për punën dhe zhvillimin profesional të Federatës së Para Boccia të Kosovës, duke krahasuar progresin e arritur me vitet paraprake. Është vlerësuar rritja e numrit të aktiviteteve, përmirësimi i organizimit të garave, krijimi i mundësive më të mëdha për pjesëmarrje të personave me aftësi të kufizuara të të gjitha grupmoshave, si dhe përkushtimi për ngritjen e kapaciteteve të klubeve, trajnerëve dhe gjyqtarëve.

Parasportistët kanë vlerësuar pozitivisht mundësinë për të qenë aktivë në gara dhe aktivitete sportive, duke theksuar ndikimin pozitiv të boccias në zhvillimin e aftësive sportive, socializimin dhe integrimin e tyre. Trajnerët dhe klubet kanë vlerësuar mbështetjen profesionale dhe përpjekjet për standardizimin e funksionimit të sportit.

Megjithatë, nga diskutimet janë identifikuar edhe fusha ku ekziston nevoja për përmirësim të mëtejshëm. Pjesëmarrësit kanë theksuar rëndësinë e rritjes së numrit të sportistëve aktivë, zgjerimit të bazës së klubeve, përmirësimit të kushteve infrastrukturore dhe sigurimit të mbështetjes më të qëndrueshme për aktivitetet sportive. Gjithashtu, është vlerësuar se përkundër progresit të arritur,

zhvillimi i sportit të boccias kërkon vazhdimësi, investim dhe bashkëpunim më të madh institucional.

Në përgjithësi, vlerësimet e marra tregojnë se aktivitetet e realizuara kanë pasur ndikim pozitiv te grupi i synuar, por njëkohësisht ofrojnë rekomandime të vlefshme për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë dhe masovizimit të sportit të boccias në Kosovë.

2.9 Monitorimi (Ju lutemi përshkruani metodat e monitorimit të aktiviteteve të zbatuara duke u përqendruar në aktivitetet kryesore të këtij 3 mujori të ndërlidhura me rezultatet e arritura.)

Gjatë periudhës janar - qershor 2026, monitorimi i aktiviteteve është realizuar përmes një qasjeje të kombinuar, duke përfshirë monitorimin e drejtpërdrejtë në terren, dokumentimin administrativ, komunikimin me përfituesit dhe analizën e rezultateve të arritura. Aktivitetet janë përcjellë në vazhdimësi në raport me Planin Vjetor të Punës (F1), përmes evidencave të pjesëmarrjes, raporteve të aktiviteteve, materialeve fotografike dhe dokumentimit të proceseve të realizuara.

Për aktivitetet sportive është përdorur monitorimi praktik gjatë garave, duke përfshirë përcjelljen e pjesëmarrjes së parasportistëve, procesin e klasifikimit funksional, organizimin teknik të garave dhe analizën e rezultateve sportive. Komunikimi i vazhdueshëm me parasportistët, trajnerët, gjyqtarët, klubet sportive dhe shoqëruesit e tyre ka shërbyer si mekanizëm për marrjen e komenteve dhe identifikimin e mundësive për përmirësim.

Një metodë e rëndësishme e monitorimit dhe vlerësimit të ndikimit ka qenë përdorimi i kanaleve digjitale të komunikimit, përmes ueb-faqes zyrtare të Federatës së Para Boccia të Kosovës dhe faqes zyrtare në Facebook, ku janë publikuar aktivitetet, rezultatet, fotografitë dhe informatat për publikun. Gjithashtu, promovimi dhe monitorimi i dukshmërisë së aktiviteteve është realizuar përmes paraqitjeve në media, intervistave në emisione televizive dhe publikimeve të shkrimeve mediale, duke vlerësuar shtrirjen dhe ndikimin e aktiviteteve te komuniteti.

Për aktivitetet institucionale është përdorur monitorimi përmes takimeve konsultative me klubet, përcjelljes së progresit në procesin e licencimit dhe vlerësimit të zbatimit të politikave të reja. Në përgjithësi, është zbatuar qasja "planifikim–zbatim–monitorim–përmirësim", ku të dhënat e mbledhura janë përdorur për rritjen e cilësisë së aktiviteteve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara në sportin e boccias.

2.10 Strategjia e Federatës dhe Strategjia Shtetërore e Sportit (ju lutem sqaroni për secilin aktivitetet të zbatuar në këtë 3 mujor, se si i ka kontribuar arritjes së objektivave të Strategjisë së Federatës dhe Strategjisë Shtetërore për Sport. Sqaroni nëse në këtë periudhë keni zhvilluar strategjinë e federatës në përputhje me Strategjinë Shtetërore për Sport)

Aktivitetet e zbatuara nga Federata e Para Boccia të Kosovës gjatë periudhës janar–qershor 2026 kanë kontribuar drejtpërdrejt në realizimin e objektivave të Strategjisë së Federatës dhe prioriteteve të Strategjisë Shtetërore për Sport, veçanërisht në zhvillimin e parasportit, rritjen e përfshirjes dhe krijimin e mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara.

Organizimi i kampionateve ekipore dhe individuale në kategoritë BC1, BC2, BC3 dhe BC4, si dhe aktivitetet promovuese me klubet sportive, kanë ndikuar në rritjen e numrit të parasportistëve aktivë, zhvillimin e konkurrencës sportive dhe përmirësimin e cilësisë së garave. Trajnimet për trajnerë, gjyqtarë dhe klubet sportive kanë kontribuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe forcimin e strukturave

organizative të sportit të boccias në Kosovë.

Aktivitetet për zhvillimin e sportit të vajzave dhe fuqizimin e rolit të grave në pozita vendimmarrëse kanë qenë në përputhje me objektivat për përfshirje dhe barazi në sport. Po ashtu, promovimi përmes ueb-faqes, rrjeteve sociale dhe mediave ka ndikuar në rritjen e dukshmërisë dhe masovizimin e sportit të boccias.

Në këtë periudhë nuk është hartuar strategji e re e Federatës, por të gjitha aktivitetet e realizuara janë zbatuar në përputhje me objektivat strategjike ekzistuese të Federatës dhe me drejtimet kryesore të Strategjisë Shtetërore për Sport, duke synuar zhvillimin e qëndrueshëm të parasportit dhe rritjen e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në sport.

2.11 Vizibiliteti dhe ndërlidhja me grupet e qytetarëve/publikun (Shpjegoni veprimet e ndërmarra për të siguruar vizibilitet të financimit nga MRS dhe Memorandumit. Sqaroni se si e keni avancuar ueb faqen e Federatës për komunikim me audiencën)

Vizibiliteti i mbështetjes nga Ministria e Sportit dhe Rinisë dhe Memorandumit është siguruar përmes publikimit të aktiviteteve të realizuara në ueb-faqen zyrtare të Federatës së Para Boccia e Kosovës, faqen zyrtare në Facebook, si dhe përmes paraqitjeve në media, emisioneve dhe shkrimeve informative. Ueb-faqja dhe Faqja zyrtare në Facebook e Federatës së Para Boccia të Kosovës është avancuar me publikimin e lajmeve, rezultateve, dokumenteve, raporteve dhe informatave për klubet, sportistët dhe publikun, duke rritur transparencën, komunikimin dhe promovimin e sportit të boccias.

2.12 Materialet/publikimet (Ju lutemi renditni të gjitha materialet/publikimet, sic janë materialet promovuese, ueb-faqja e federatës, printime të tjera promovuese të shtypura apo publikuara në formë virtuale në këtë 3 mujor)

Gjeni më posht fotografi nga aktivitetet e realizuara në periudhen janar - qershor 2026:










Kryetari i Federatës:

Emri dhe mbiemri: Murat Murati

Nënshkrimi:  Vendi: Prishtinë

Data: 14.07.2026

